



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.753/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelin e Mentor Berisha, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Obiliq, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar apeli i Mentor Berisha, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Obiliq, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Obiliq.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Obiliq, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Obiliq në Vendvotimet: 1503E/ 01R, 1503E/ 02D në fshatin Breznicë të Komunës së Obiliqit.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën - II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 09.11.2017, nga Mentor Berisha, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Obiliq, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, me të cilën pretendon se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave në fshatin Breznicë të Komunës së Obiliqit, vendvotimet 1503E/ 01R, 1503E/ 02D, ku gjatë numërimit të votave kanë bërë marrëveshje komisionerët në mes vete që të shkon një kandidat nga radha e LDK-së me nr. 17 dhe të gjitha votat tjera që kanë qenë për kandidatët e tjerë janë bartur kandidatit me nr.17 dhe pse të gjithë votuesit janë të LDK-së dhe mendon se kanë votuar për të.

Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur një listë me nënshkrime të personave që kanë votuar për të.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe shkresat e tjera si dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara, për faktin se nga dëshmitë e ofruara nga apeluesi që gjenden në shkresat e lëndës ka vlerësuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura me vendimin e KQZ-se me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit për vendvotimet e cekura në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal në Obiliq nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për vendvotimet e lartcekura, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

Prandaj, PZAP-it me qëllim të evitimit të lëshimeve të lartë cekura vendosi si në pikën II të dispozitivit të vendimit duke u bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Nga sa u tha me sipër duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa

ZL.A.nr.753/2017 me datë 12.11.2017

**Kryesuesja e Panelit
Gylene Sylejmani**



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.